



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË

Programi: **Master i shkencave**

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: **ZHVILLIMET DEMO-SOCIALE DHE EKONOMIKE NË HAPËSIRËN SHQIPTARE**

<i>Pedagogët:</i>	Prof. dr. Sabri LAÇI, Dr. Edlira KOLA
<i>Ngarkesa:</i>	5 ETCS (36 orë lex./18 orë seminar/18 orë ushtrime, 1 detyrë kursi)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Lënda u ofron studentëve njohuri të thelluar mbi çështjet që preokupojnë shqiptarët në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, Greqi, diasporë, si: papunësia, varfëria, përjashtimi social, vështirësitë dhe sfidat e integritimit të migruesve të brendshëm dhe emigrantëve; rolin e komuniteteve, qeverisjes vendor dhe qendrore në zhvillimin social-ekonomik dhe integrimin rajonal.

Temat:

1. Hyrje. Objekti, përmbajtja, detyrat dhe rëndësia e studimit Gjeografisë së zhvillimeve demosocial dhe ekonomike në hapësirën shqiptare (HSH).
2. HSH në Ballkan – turrja gjatë shekujve dhe copëtimi i vitit 1913. Përpjekjet për korrigjimin e padrejtësive të historisë. Statusi i sotëm i pjesëve përbërëse të HSH-së.
3. Shqiptarët – një ndër popujt më të vjetër në rajon. Zhvillimet demografike dhe burimet njerëzore. Karakteristika të përgjithshme demografike. Numri, shpërndarja gjeografike, lëvizja natyrore dhe veçoritë strukturore të popullsisë në HSH. Burimet njerëzore si premisë për zhvillim.
4. Lëvizjet migruese të shqiptarëve gjatë shekujve dhe krijimi i diasporave. Migrimet e brendshme dhe emigracioni i sotëm: shkaqet (papunësia dhe varfëria), përmasat, drejtimet dhe pasojat.
5. Familja dhe komuniteti. Marrëdhëniet në familje dhe komunitet. Gjendja e strehimit, banesat, mënyra dhe niveli i jetesës. Shtresëzimi, përjashtimi, diskriminimi dhe integrimi social. Shërbimi, infrastruktura dhe punonjësit socialë.
6. Arsimi dhe kultura. Infrastruktura, personeli arsimor dhe nxënësit. Niveli arsimor dhe analfabetizmi. Objektet social-kulturore, sportive, fetare dhe veprimtaritë social-kulturore në HSH.
7. Shërbimi shëndetësor: infrastruktura, personeli shëndetësor sipas kualifikimit dhe specialiteteve, gjendja shëndetësore e popullsisë.
8. Veçoritë e zhvillimit ekonomik të HSH: diversiteti i përcaktuar nga politikat ekonomike të ndryshme. Përpjekjet për integrimin ekonomik të HSH-së. Punësimi sipas degëve të ekonomisë dhe sektorëve (publik, privat).
9. Ekonomia bujqësore - sektor i rëndësishëm në HSH. Degët dhe nëndegët. Problemet e sotme dhe

perspektiva e ekonomisë bujqësore.

10. Sektori dytësor i ekonomisë: objektet dhe veprimtaritë industriale, artizanati dhe ndërtimtaria. Specifikat dhe roli i këtij sektori në zhvillimin ekonomik të HSH-së.
11. Sektori terciar në HSH. Transporti dhe telekomunikacioni në proces zhvillimi dhe modernizimi.
12. Tregtia me shumicë dhe pakicë. Përpjekjet për krijimin e hapësirës tregtare të përbashkët dhe nisma "bli shqip". Shërbimi bankar dhe investimet.
13. Turizmi dhe restorantaria: mundësi të mëdha për turizëm gjithëvjetor në HSH. Rruga e Kombit dhe "turizmi patriotik".
14. Shërbimi i furnizimi me energji elektrike. TEC-et në Kosovë, HEC-et në Shqipëri dhe shkëmbimi stinor i energjisë. Linjat e interkonjeksionit Shqipëri-Kosovë. Furnizimi me ujë, evakuimi dhe pastrimi i ujërave të përdorura; grumbullimi, përpunimi dhe riciklimi i mbetjeve urbane. Shërbimet e tjera në HSH.
15. Qeverisja vendore. Format tradicionale të zgjidhjes së konflikteve dhe vetëqeverisjes. Qeverisja në periudhën 1945-1990. Decentralizimi i pushteteve dhe qeverisja sot. Pjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje – një nga objektivat e mijëvjeçarit.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursit ose ese: rreth 15 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5): 20% e notës	
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. S. Laçi, *Gjeografia e zhvillimeve demosocial dhe ekonomike në HSH*, Cikël leksionesh. Tiranë 2015.
2. A. Pushka, *Aspekte gjeosociale dhe gjeoekonomike në Kosovë*, ALB SHTANZ, Prishtinë 2002.
3. F. Skënderi, *Popullsia dhe vendbanimet shqiptare në Maqedoni*, Komanovë 2006.

Literatura plotësuese:

1. ASHAK, *Kosova – vështrim monografik*, Prishtinë, 2011.
2. Civici A., *Dilemat e zhvillimit: modelet e zhvillimit ekonomik e social përballë globalizimit*, GEER, Tiranë 2007.
3. Dervishi Z., *Vullnetarizmi – ind shumëfunksional i shoqërisë*, albPAPER, Tiranë 2004.
4. Dumani B., Stringa A., *Demografia socio-ekonomike*, PEGI, Tiranë 2009.
5. Fuga A., Dervishi Z., *Ndërmjet fshatit dhe qytetit global*, Jeruzalem, Tiranë 2002.
6. INSTAT, *Censusi 2011 dhe botime periodike*.
7. Instituti i Statistikave të Kosovës, *Të dhëna të regjistrimeve të popullsisë dhe botime periodike*.

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. dr. Romeo HANXHARI

Tiranë, 2016